

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

“Digital Space” sh.p.k

Në bazë të ligjit ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, me vullnetin e tyre të lirë të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot më datë 15/09/2023, Themeluesi:

1. **Skerdian Kacuqi**, Lindur në Durres me 29.07.1990 ,me nr personal J00729066M.

Deklaron se ka vendosor të nënshkruaj këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë referuar si Shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti duke respektuar edhe kërkesat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare.

Neni 1-Emërtimi
Emërtimi i shoqërisë është

“Digital Space” sh.p.k

Ne të gjitha aktet e dokumentat që dalin nga shoqëria emertimi i saj do të paraprihet (ose do të ndiqet menjëhérë) nga inicialet “SH.P.K” dhe nga shpallja e kapitalit themeltar.

Neni 2-Vëndndodhja e selisë

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet: Durrës ,Lagija nr14,Ruga Bajram Tusha, Shkozet , Nr,Pasurie 100-7433, Durres

Neni 3- Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së rregjistrimit të saj në Qendren Kombetare te Rregjistrimi.



Neni 4- Objekti i veprimtarisë

- Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si vijon:

1. Shitjen me shumice e pakice te artikujve te ndryshem. 2. Programime software dhe zgjidhje nepermjet teknologjise se informacionit. Sherbime dizajni dhe grafiku. 3. Sherbime audio dhe video. 4. Sherbime marketingu, printime, online, reklama 3D etj. 5. Konsulencë te ndryshme lidhur me fushat e marketingut dhe telemarketingut.

Neni 5- Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërise është 500.000 (Peseqind mijë) leke.

Kapitali themeltar është i perbërë nga 1 (Nje) kapital i vetëm me vlerë nominale 500.000 (Peseqind mijë) leke.

Neni 6-Kontributet dhe pjesët e kapitalit themeltar

1) Kapitali themeltar i shoqërise është 500.000 (Peseqind mijë) leke.

Kapitali themeltar është i perbërë nga 1 (nje) kapital i vetëm me vlerë nominale 500.000 (Peseqind mijë) leke.

Sipas kontributeve në kapitalin themeltar të shoqërisë pjesët e tij ndahan:

Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht ne te holla nga ortaket e shoqerise perkatesisht:

1. **Skerdian Kacuqi**, Lindur në Durres me 29.07.1990 ,me nr personal J00729066M, vlera e kapitalit te per gjithhem **500.000** Leke, numri i pjeseve 1, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqeshen nga letra me vlore te tregtueshme dhe as me kontribute ne sherbime.

Ortaku per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise

Neni 7- Transferimi i pjesëve të kapitalit

1. Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për shoqeritë tregtare" dhe nga statuti i shoqërisë.

Neni 8- Administrimi

1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta edhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Zakonshme.

- Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë, dhe në emër të saj në të gjitha rrëthanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.
- Administratori i vetem i shoqërisë është Skerdian Kacuqi**, Lindur në Durres me 29.07.1990 ,me nr personal J00729066M.

- Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara për këtë akt dhe aktet që rrjedhin prej tij u përkasin bashkarisht dhe solidarisht nënshkruesëve në përpjestim me kontributet e tyre deri sa shoqëria të rregjistrohet në rregjistrin tregtar.

Neni 9- Të tjera

- Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni - 10

- Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likujdimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të diskutohen në menyre të drjetpërdrejtë midis të interesuarëve per ti zgjidhur me pajtim. Në rast të kundërt i nënshtronen juridiksonit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

Neni - 11

- Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barabarta dhe të barazvlefshme.

Parë dhe miratuar në Durres , më 15/09/2023.

ORTAKU I SHOQERISE

SKERDIAN KACUQI

Skerdian Kacuqi

[Handwritten signature]